



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 26.09.2025
Nr. 5 - 2221

Komisioni për licencimin dhe rilicencim të BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4 dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 në bazë të neneve 5, 6, 7 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë dhe Udhëzimit administrativ nr. 17/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit administrativ (MASHT) 25/2012 për licencimin e bartësve privat të arsimit të lartë në Kosovë, kërkesës nr. 5-2221 të datës 12.06.2025 të parashtruar nga BPrAL “Akademia Evolucion”, nxjerr:

V E N D I M
Për rilicencimin e Kolegjit “Akademia Evolucion”

1. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji “Akademia Evolucion” në Prishtinë, licencohet në nivel institucional për periudhën (3) trevjeçare (1 tetor 2025 - 30 shtator 2028), sipas vendimit të AKA-s.
2. Rilicencohen programet e studimit për periudhën (5) pesëvjeçare (1 tetor 2025- 30 shtator 2030):
 - 1.1. Dizajn i Modës 180 ECTS (BA) me kuotën maksimumi 60 studentë për vit akademik;
 - 1.2. Dizajn i Modës 120 ECTS (MA) me kuotën maksimumi 60 studentë për vit akademik;
 - 1.3. Dizajn i komunikimit, 180 ECTS (BA) me kuotën maksimumi 60 studentë për vit akademik.
2. Licencohen programet e studimit për periudhën (3) trevjeçare (1 tetor 2025- 30 shtator 2028):
 - 2.1. Stilizim dhe Komunikim në Modë, 180 ECTS (BA) me kuotën maksimumi 60 studentë për vit akademik.
3. Bartësi priva i arsimit të lartë, Kolegji “Evolucion”, sipas paragrafit 1 të këtij vendimi, mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim ose tejkalim të këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ Kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ka shqyrtuar kërkesën me nr. 5-222 të datës 12.06.2025 të parashtruar nga BPrAL- Kolegji “Akademia Evolucion” dhe vendimeve të Agjencionit të Kosovës për Akreditim me nr. ref. 595/25 datë: 27.05.2025.

Licenca e Kolegji “Akademia Evolucion” zgjat sipas dispozitivit të këtij vendimi si në nivel institucional dhe të programeve të studimit duke u bazuar në vendimet e nxjerra nga AKA:

Komisioni për Licencim dhe rilicencim në MASHTI duke marrë parasysh faktet e ofruara nga ky institucion si dhe dokumentacionin për aplikim, kërkon nga Kolegji Evolucion që brenda vitit kalendarik deri më 01 shtator 2026 të ofroj lejen e legalizimit dhe vendimin për ndryshim të destinacionit nga ai afarist në veprimtari arsimore nga organet kompetente të Drejtorisë së Urbanizmit-Komuna e Prishtinës.

Nëse brenda vitit kalendarik nuk dorëzohet leja e legalizimit dhe vendimi për ndryshim të destinacionit nga organi kompetent - Drejtoria e Urbanizmit, Kolegjit Evolucion me Qendër në Prishtinë, nuk i lejohet regjistrimi i studentëve për vitin akademik 2026/2027.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi në Komisionin për ankesa të nëpunësve publik dhe ankesave të tjera në MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Kolegjit “Akademia Evolucion”;
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm/MASHTI;
4. DALSH;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. DNJBIA;
7. Arkivit.

Kryetar i Komisionit

Burim Gashi